

Parathënje e Lahutës së Malcís

Për botimin Jubilar të 100-vjetorit, 1905-2005

At Zef Pllumi

Pak histori kombtare

Fillimi i shekullit njzetë.

Si gjindej Shqipëria në atë kohë? Në kulmin e mjerimit. Jo vetëm që nuk kishte zhvillim ekonomik e kultural, por në shumicën e popullsisë nuk dukeshin kurrkund as ndjenjat e natyrshme njerzore të lirisë, barazisë e ato kombëtare. Gjumi letargjik i injorancës m^a të mbrapambetun e nënshtimi shekullor ndaj robnisë e kishin marrakotë krejtësisht kët vend e kët popull. Tempujt e bukurisë kombëtare e europjane ishin rrafshue per tokë ashtu si edhe kishin dalë nga kujtesa luftat heroike legjendare që dikur ishin zhvillue për mbrojtjen e lirisë e të nderit kombëtar e të kulturës së lashtë. Pushtuesit e huej kishin synue që me anën e ndrrimit të bindjeve e të ndërgjegjes ta shndrronte kët popull jo vetëm në një rob të thjeshtë, por m^a tepër në një shërbtuer besnik, e përkrahës të zellshëm në shtypjen e lirisë së popujve të tjerë.

Për t'i shpëtue robnisë pjesa më e kamun e ktij populli kishte ikë c strukë atje ku mund të ruente traditat. Ndërkaq një pakicë e vogël, kalue ndër male shqiptare, e vazhdoi luftën me pushtuesit për jetë a vdekje. Pionierët e kësaj qendrese kjen kryesisht klerikët katolikë që nëpërmjet fesë mendonin me shpëtue kombin e gjuhën e tij, si tipari kryesor, doket e traditat e lirisë. Edhe sot mbeten emnat e ktyne pionerëve: Buzuku, Matranga, Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi, etj. etj., të cilët me anë të ndërgjegjes fetare dhe të kultivimit të saj, që në atë kohë ishte m^a emocionale se ndjenja komëtare, menduen me shpëtue jo vetëm lirinë, por edhe dashuninë për kët tokë e për kët popull.

Me kalimin e kohëve, atje në Europë, tashmâ të largët për ne, u zhvillue përvç ndërgjegjes fetare edhe një ide e re: Iluminizmi, ose i quejtun ndryshe ndërgjegja e mendimit të lirë. Iluminizmi - *besimi i mendimit të lirë, pothuej u shpall si fe e re*. Ky besim i ri nuk kishte si të mos ndezej në gjinin e një populli të shtypun në robni. Dikund atje i strukun ndër malet e largëta të Vithkuqit shpërtheu "*fenomeni Voskopojar*". Nji aleancë e ngushtë me shokun e vujtjeve, popullsinë Vllahe, populli shqiptar krijoi mrekullinë e re me themelimin e qytetit të Voskopojës, qendra e iluminizmit shqiptar. E qëllimi kryesor kje: mendimi i lirë i 'mbrujtun përmes kulturës. Mendimi i lirë do të çonte pa tjetër ne veprime të lira. Akademia e Voskopojës nuk kje një çfaqje e huej, por thjeshtë kombëtare. Ajo jo vetëm që vuni përpjekje me qandra të Europës perendimore, por mendonte me e shtri kulturën edhe në vise të tjera të Shqipnisë, sepse besonte se vetëm 'kultura mund të sillte lirinë. Atje u kultivuen talentet shqiptare në shkencë, letërsi e arte, gjurmët e të cilave, për fat të mirë, kan teprue gjithnji atje.

Mjerisht nuk do të vononte që drita e mendimit të lirë, e iluminizmit kombëtar, të vriste sytë e pushtuesit që përfaqësonte errsinën dhe injorancën. Ky tue shfrytëzue forcat e fanatizmit atavik e shkatroi me zjarm e shpatë qandrën e kulturës së re shqiptare. E gjithëka u shue. Errsina marrakoti përsëri kombin që nuk piptinte mâ as ndër malet e Verit as të Jugut.

Nga rrenojat e kulturës Voskopojare kishte teprue një fëmijë i vogël, por që kur u rrit i lëshoi kombit një kushtrim për bashkim, kulturë e liri. Ky kje shqiptari i madh Naum Vithkuqari ose i njoftun Veqilharxhi. Megjithëse historiografia shqiptare nuk e ka fare në rabush un mendoj se ky kje burizani e përçuesi i vetëm i zgjimit të ndërgjegjes kombëtare në atë kohë, titan ndërlidhës mes territ toksor e qiellit të ndritun.

Kushtrimi i tij nuk ra në vesh të shurdhët. Mirë e ndigjuen edhe disa beglerë shqiptarë, të cilët dikur e kishin kuptue se njerzimi nuk mund sundohej gjithmonë vetëm me anë të dhunës xhahile, por

duhej të kishte vend më tepër arsyeja e ditunia që fitohej me anë të shkollës, fakt ky i sprovuem ndër Bushatlitë e Shkodrës kur sundimin e patën në dorë Mehmeti e i biri Mahmudi. Ky mësim u përvetësue (ndërgjegjësue) te Dinollarët e Çamërisë, Vlorajt, Frashërlijt e Përmetit, bejlerët e Konicës etj. Në rrjedhën e iluminizmit shqiptar u shfaqen edhe shanse të reja: Bektashizmi shqiptar, Arbreshët e Italisë dhe Arvanitasit e Greqisë. Kështu gjindemi para një praku historik gjithë shqiptar ku, në qendrën historike të rezistencës shqiptare, në kurrfarë mënyre nuk përjashtohej Kleri Katolik Shqiptar. Kto rryma të ndryshme të gjitha vepruen për të njatin qëllim: Lirinë e Shqipnisë.

Që nga ajo ditë që urditë turke u thyen në rrethimin e Vjenës, kryesisht falë forcave polake, Perandoria Osmane filloi teposhten e vet të pashmangshme. Mâ vonë revolucionin francez pruni një ndryshim të madh jo vetëm në politikë, por në të gjithë mendimin kulturor. Gjatë perjudhës së perandorit ilegjitim Napoleon Bonapartit, idetë e besimet e revolucionit francez, jo vetëm që ishin të pranishme, por dhe u përhapën gjithkund e u bënë agresive.

Përveç filozofisë, nga shoqëritë e mshefta e sekrete të quejtuna "masonike", lindën edhe dy rryma të reja agresive: nacionalizmi e internacionalizmi. Kto rryma të reja dashtë e padashtë hyne aso kohe edhe në Perandorinë e madhe Osmane. Sa për internacionalizmin Perandoria nuk çante kryet fare, sepse ajo vetë; e mbështetun në ligjet Kuranike, ishte internacionale, shumkombshe, por ajo e nacionalizmit zgjoi ndjenjat kombëtare, së pari të grekëve, e mandej të rumunëve e të sllavëve. Luftat e vazhdueshme të Perandorisë së madhe ruse kundra Turkisë, tue ia fillue që nga Kaukazi e në Krime, kishin shkaktue shumë humbje terrioresh osmane edhe ndër vendet krejt islamike të Kaukazit! Gjithashtu, në luftat heroike të grekëve për pamvaresi kjenë edhe forcat vullnetare ruse të drejtueme nga gjeneral Ypsilanti si edhe arvanitasit e Greqisë.

Në vazhdim të kësaj politike ruse u hap fronti ballkanik, ku në përgjithsi elementi fetar i krishtenë kishte prioritet. Në luftën ruso-turke të vitit 1876 ku popujt ballkanikë kristjanë duelën fitimtarë, u gjetën para një gjendje konfliktuale. Epoka historike post-napoleoniane karakterizohej nga dishiri i të gjitha fuqive europjane për t'u ba fuqi koloniale ose më saktë dishiri për të shfrytëzue të gjitha ato vende ku ende nuk njihej ndjenja nacionale. Dishiret e pangopshme kapitaliste kërkonin burime të reja fitimi e shfrytëzimi. Kjo ishte tendencë e përgjithtë, prandej politikani i madh gjerman Bismarku thirri Kongresin e Berlinit. Ktu u hapën kjashtas hartat gjeografike të dishireve: Rusia dhe kombet ballkanike ishin fitimtarët, por u vunë në pah edhe dishiret e Perandorisë Austro-Hungare si edhe ato të Italisë; Franca e Anglia paraqiteshin si aleatë të Turakisë ose së paku si dashamirë. Gjatë Kongresit të Berlinit për te parën herë u përfaqësue populli shqiptar në personin e Abdyl Bej Frasherit, aso kohe deputet në mishlizin ose parlamentar turk. Ai shkoi në atë Kongres si përfaqësues i Lidhjes së Shqiptarëve të Prizrenit.

Praktikisht kjo Lidhje kje e para mbledhje e gjithë shqiptarëve pa dallim feje e krahinash dhe nacionalizmi shqiptar filloi jetën e vet aktive ndër të gjitha nivelet, sepse muer pjesë i gjithë islamizmi shqiptar.

Në historinë kombëtare të popullit shqiptar mund të thomi se pishtari i dritës e i lirisë kaloi dorë në dorë gjatë shekujsh në këtë mënyrë: Kleri Katolik Shqiptar, Arbëreshët e Italisë, Voskopoja shqiptare, Arvanitët grekë që dhanë kontributin e madh me Marko Boëarin e së fundi me Anastaz Kulluriotin, tue ia dorëzue stafetën beglerëve shqiptarë me përfaqësuesit e mdhaj Bushatlijtë si dhe Dinollarët e Çamërisë, e së fundi me Frashërlijt të cilët i dhanë drejtimin kombëtar që ndrydhej në zemër edhe gjithë bektashizmit shqiptar derikah gjysa e fundit e shekullit të nantëmdhetë.

Mjerisht duhet të thomi se të gjitha kto rryma kombëtare të popullit shqiptar nuk kishin kurrfarë lidhje me njana-tjetrën, por vepronin tepër të përqamë.

Mbas vdekjes së Naim Frashërit, stafeta u kaloi më tepër Faik Konicës e Gjergj Fishtës, të cilët menduen kryesisht për të bërë bashkimin e të gjithë popullit shqiptar. Sigurisht që kjo barrë do të ishte tepër e rëndë edhe sot mbas një shekulli e jo më në fillim të shekullit të kaluar.

Megjithatë Fishta e ka shkruar të gjithë talentin e tij, jo vetëm si letrar, por edhe ndër fusha të tjera të mendimit, kulturës e politikës për këtë qëllim. Për ta vërtetuar këtë mjafton vetëm një fakt historik i jetës së Fishtës të cilin e kam ndigjuar vetë nga goja e tij:

"U mbledhëm të gjithë njerëzit më të ditur të Shqipërisë në Manastir për me caktuar alfabetin me të cilin duhej shkruar gjuha jonë, sepse në atë kohë ajo shkruhej në afër dhjetë mënyrash. Kryetari i Kongresit u caktuar Mit'hat Bej Frashëri, mbasi baba i tij, Abdyl, kishte ndezur Lidhjen e Prizrenit. Ishim nga të gjitha skajet e Shqipërisë dhe të kolonive shqiptare ndër dhena të hueja. U treguem me të vërtetë shqiptarë sepse kurjani nuk donte me i lëshuar asnjë fije penë nga mendimi i vet atij tjetrit. Kongresi duhej të shpërdahej pa marrë kurrë vendim. U tërhoja nga inati. U çova në kambë e u fola:

- O burra shqiptarë po a me të vërtetë do t'i lëmë marrë vedit për të gjithë botën? Po a mendoni ndopak se çka do t'u thomi shqiptarëve kur të na pëveshin se çka keni bërë ju dijetarët atje në Manastir? Çka do t'u thomi na njerzve të pashkollë që nuk dinë as me shkruar as me kënduar? Na jemi që mendojmë me bërë Shqipërinë e si do ta bëjmë atë kur na nuk duem me u marrë vesh ndërmjet vedit se si duhet me u shkruar germa A e ajo P. Burra po u flas me zemër në dorë se është marrë e turp e faqe e zezë me i lënë marrë vedit për popullin shqiptar e për tanë botën, që pret dishka prej nesh e na të kthejmë pa kurrëgjatë në dorë ndër shpija tona. Por ulnjo

burra, ulnju sheshit e pse të kalojmë edhe një ditë më shumë në këtë vend, mos ta lamë duer bosh popullin që na pret!...

Aferim! P. Gjergj!... Aferim të kjoftë, - bërtiti me të madhe një hoxhë me mjekërr. Ai u çue në kambë e erdh drejt te un, më puthi në ballë e më tha: Kështu flet shqiptari që e di që është shqiptar!... Ulnju burra, - u tha, - ulnju këtu në shesh të zgjedhim një komision e në krye të vemë Pater Gjergj Fishten e vetëm komisioni do të caktojë se shka duhet të bajmë sot për të mirën e popullit shqiptar nesër!.. ..

Fjala e tij u ndigjue me duartrokitje e më caktuen Kryetar të Komisionit të Kongresit të Manastirit, i cili do të delte bosh sikur mos të ishte tregue toleranca e eme që të pranojshim dy alfabetet njëherit, atë të Stambollit që kërkonte Mit'hat Frashëri dhe këtë që u vendos.

Kjo sjellje e emja në Kongres të Manastirit më ka kushtue mjaft shtrejt në jetë sepse Abat Doçi, të cilin un e përfaqsova në atë Kongres m'u idhnue e kur u ktheva më tha: Pater Gjergj, un të kam dijtë si nieri që nuk ban kompromis në jetë!... Por Shqypnija nuk mund të bahej ndryshe ... "

Poeti dhe Poema

Poeti që në moshën fëminore hyni në Kolegjin Françeskan të Troshanit që aso kohe drejtohej nga arbëreshi italian At Leonard De Martino, atdhetar, njeri i letrave e kulturës, plot aktivitet shoqnor. Nën drejtimin e tij Fishta, aso kohe Zefi i vogël, muer mësimet e para në gjuhët italiane, latine, greke antike, si edhe edukatën e parë fetare e atdhetare. Studimet e mesme i vazhdoi në Bosnje, që aso kohe ishte nën proteksionin austro-hungar.

Përveç pak kolegësh shqiptarë ai studioi Filozofinë e Teologjinë me shokët e vet boshnjakë. Thohet se ndër të gjithë dallohej për talent të veçantë. Aty u njoft edhe me gjuhët gjermane, franceze e sllave. Përmes përkthimesh njofti dhe letërsinë angleze. Ndëkaq nuk i

harroi, por i vlerësoi edhe kangët gojore shqiptare, deri aso kohe të pambledhuna. Atje filloi, në gjuhë të huej, edhe poezitë e para. Udhëheqësi i tij në letërsi kje një ndër poetët e njoftun të serbo-kroatishes. Kështu ai kishte një kulturë tepër të haptë në letërsinë botnore. Pëlqente klasikët e mdhaj të letërsive greke e latine e ndoshta mendonte të kishte si model poetin latin Horacin, lirik e satirik. Ai shkroi shumë satira që qarkullonin dorë më dorë në përdorim të mbrendshëm, por filloi me botue dhe shumë satira politike, kryesisht në revistën "Albania" të Faik Konicës, nën pseudonimet *Costigat ridento*, *Fushkë në dushkë*, etj. etj. të cilat kanë shumë përgjajme të satirikut italian Giuseppe Parini, gjithashtu po me atë revistë provoi të shkruaj kangë trimënie nën pseudonimin "e Popullit".

Në vjetën 1903, ndërsa ishte emnue drejtor i "Shkollës Franëeskane" dhe vuni si gjuhë mësimi ndër të gjitha landët gjuhën shqipe, gjatë pushimeve verore shkoi në Hot për me zavendësue famullitarin. Aty u njoft shpirtnisht e personalisht me malsorët. Mendoj me shkruaj një kangë baritore si bukoliket e Virgjilit, të këtij poetit të madh latin e në gjasim të eklogës së parë e cila fillon kështu:

Tityre, tu patulae recubans sub tegmine fagi

Silvestrem tenui, Musam meditaris avena;

Nos patriae finis et duleia linquimus avarva.

Nospatriam fugimus; tu, Tityre, lentus in umubra ...

Fishta e filloi këngen e Marash Ucit:

Te një mri, te një lejthi

Kishin ndodhun tre bari

Dy me dhen e një me dhi

Marash Uci e t'bijt e Calit

Dy djelm t'lehtë si shpezët e malit. (etj)

Onomatopeja në mes të ktyne vargjeve, edhe pse në gjuhë të ndryshme ndjehej tepër kjartë.

Fishta e kishte zakon që poezitë e veta t'ua dërgonte kolegëve, miqve të vet, për t'i dhanë mendimin. Kjo kangë u pëlqeu të gjithëve pa përjashtim, të cilët jo vetëm e përgëzuen, por i kërkuen që kët kangë ta vazhdojë, madje i kërkuen që të shkruente një vepër që të përfaqsonte "Epikën Shqiptare". Edhe Faik Konica i shkruente kështu: "Sikur të gjitha poezitë e shqipes të shkruheshin me kët tonalitet, me kët energji, letërsia e shqipes do të zinte vend ndër të gjitha letërsitë europjane" ... Edhe Abat Doçi i Mirditës i tha: "Ndigjo Pater Gjergj, populli shqypetar për me u lirue nga robnia shekullore ka nevojë me i nxitë trimninë e të parëve. Shkruej një epikë, sepse ajo sot i nevojitet popullit shqypetar që kërkon lirinë".

Aso kohe Abat Doçi ishte personaliteti më i madh i patriotizmit shqypetar. Fishta e adhuronte dhe bante pjesë në grupin e itelektualëve që të organizuem prej tij formuen "Shoqnin Bashkimi", të cilën Asdreni e ka quajtur "Akademia". Fishta iu vu punës që t'ua plotësonte dishirin, dhe kështu, siç shifet në një fletë dorëshkrimi të vjetit 1904 me alfabetin e Bashkimit ai shkruen:

Lahuta e Malcís - Fillimi

Te Ura e Rrzhanicës

Shqypetar!
Kët kangë vetë e kam shkruar;
Por m' 'thuej, çka kam fitue?
Idhnim e t' çame kreje
Me t'ba me dalun feje! ...

E pra tash kallxon moti
Se a kjesh kangtar i zoti...

Por s'asht per t'u çuditun;
Pse kur mbí dhé t 'pa pritun

Kryekungujt vehen t'parë;
Vaj halli! Per kangtarë ...
Ani; kryekungujt desin;
Por kangët e mija jesin .

Kështu nxjerrim një farë dyshimi në se Fishta ishte ba pishman për një ndërmarrje kaq të madhe pa e fillue mirë punën. E kah t'ia fillonte? Ai kishte parasysh pjesën dërmuese të epopeve botnore, të cilat u këndoishin trimnive të një heroi protagonist legjendar, ndërsa Lahuta e Malcis cilin do të kishte?

Megjithkta ai e vazhdoi punën dhe në krye të vjetit, nën kujdesin e kolegut të tij At Pashko Bardhi, që aso kohe kishte hapë shkollën e Arbëneshve në Zara të Dalmacisë, boton këtu një librec të vogël, i cili bani një zhurmë të madhe ndër të gjithë intelektualët shqiptarë. *Ai e botoi si kangë populllore, sepse aso kohe një shkrimtar nuk mund të shkronte shqip, prandaj u ba libër xhepi që hini tinzë në Shqipni dhe u shpërnda msheftas, dorë më dorë.* Ky botim pati si moto vargjet e poetit latin Horac Flakut:

Tyrtaeus mares animos ad
Martia bella Versibus exacuit

Të cilat po t'i përkthej më shqip thonë:

Tyrteu me anë të kangëve të veta
U dha zemër burrave për lufta të vështira

Ky librec pat 48 faqe me pesë kangë: 1. Marash Uci; 2. Besa e lidhun; 3. Kushtrimi; 4. Kasneci.

Poeti në Shqipni pat me të vertetë rolin e Tirtut antik, sepse kangët e këtij libri jo vetëm entuziazmuen njerëzit që dinin me lexue, por ato i xuni përmendësh edhe çdo analfabet që filloi me u këndue me lahutë në çdo votër shqiptare.

Me gjithë suksesin e madh që pat, Fishta nuk kje i knaqun. Ai e dinte se malsorët e krishtenë nuk kishin nevojë aq shumë. Ai mendoj më tepër për me ndezë flakë zemrat e popullit shqiptar me shumicë myslimane, prandej, menjherë pregatiti blenin e dytë të Lahutës së Malcis me Oso Kukën si hero i Vraninës.

Edhe ky bleni i dytë nëpër kujdes të At Pashko Bardhit, koleg i Fishtës, u botue në Zara të Dalmacisë, në shtypshkronjën e Vatalianit; botue në vjetin 1907, pa datë e pa emën.

Msheftas u shpërnda në Shqipni e kolonitë shqiptare. Ky librec pat 52 faqe i damë në katër kangë: 1. Çeta; 2. Cubat; 3. Kuvendi i Cetinës; 4. Deka. Suksesi kje i jashtzakonshëm. Nuk mbet kurrnji shqiptar pa e lexue, pa e xanë përmendsh. Fishta me këtë poemë u ba "Poet Kombëtar". Lahuta e Malcis sot e deri tash u ba e të gjithë kombit. Po në atë msheftësi që u shpërnda libri, po ashtu u përhap edhe emni i Fishtës në të gjith popullin shqiptar. Nji vit më vonë, kur shkoi në Kongresin e Manastirit, ai kishte sigurue besimin e të gjithë shqiptarëve. Edhe pse në këtë Kongres disa e shifshin për të parën herë, jo vetëm që e duartrokitën, por e emnuen si Kryetar i Komisionit për të vendosun alfabetin e shqipes. Fishta nuk ishte gjuhtar, nuk ishte njeri fanatik i kurrnji ideje a shkence. Ai kërkonte me çdo kusht bashkimin e shqiptarëve. A thue ia doli? ..

Mjerisht jeta e çdo njeriu vjen e rrokulliset si nuk don vetë. Shekulli i njëzetët pruni shumë të paprituna e të gjitha me shpejtësi marramendëse. Fishta dashtë e padashtë u ba nji ndër faktorët kryesorë në çashtjet shqiptare: Konstitucioni i Turakisë, Xhemjeti, Kryengritja e malsorëve, lufta ballkanike, rrethimi i Shkodrës, pamëvarsia e Shqipnisë e lufta e parë botnore e të gjitha ngjarjet që erdhën me vrull, e detyruan poetin të vozisë në këtë vorbull gjigante të njerëzimit. Gjatë kësaj perjudhe të termekshme ai nuk e lëshoi kurr pendën nga dora. Ajo kje arma e vetme e tij për t'i dalë zot popullit të vet shqiptar, kundra çdo anmiku që paraqitej ndër ato vite uraganesh.

Shkroi lirika, drama, publicistikë, satira, si t'ia kërkonte rasti, por ndoshta si duket, a e kishte gjithnji ndër mend Lahutën e Malcis. ... Sigurisht që po. Por ... por i kishin dalë shumë pengesa në rrugë. Çfarë lidhje historike kishin mes vedit Bleni i parë i Lahutës ose Marash Uci me Oso Kukën e bleni i dytë: Jo, ndërmjet vedit as nuk i lidhte koha as vendi. Ku ta gjente Fishta një tjetër hero legjendar? Skanderbegu ish një figurë e provueme nga Naim Frashëri, por pa sukses, sepse gjatë shekujve të robnisë së gjatë shqiptarët e kishin harrue krejtësisht. E pra populli ynë nuk kishte tjetër kohë heroike. Në vjetën 1915 kthei gjithnji atje, shkroi poemën Moisi Golemi, por jo nën emnin e Lahutës së Malcis. Moisi Golemi e Deli Cena paraqitnin skemën ideale të një epopeje shqiptare me protagonist e antagonist. Por çka? ... populli nuk i njifte më. Prandaj e braktisi. Fishta kishte si kritik të vetin vetëm popullin e vet analfabet. Në vjetin 1940, dërsa ishem student në Troshan, Fishta kalonte ditët e veta të mbrame. Gjithë ditën e lume aty jashtë te çezmja, në një karrige xunkthi, nën hije të pjergullës e të fiquve, mes zadrimeve të vet analfabetë. Si ju duket? .. Ai e shifte përgjigjen negative, e shifte se popullit nuk i pëlqen. E braktiste punën.

Lahuta e Malcís – Vepra Kombformuese

Gjithnji tue pasë mendjen te Lahuta e Malcis atij i erdh mendimi gjenial që t'i bashkonte ngjarjet e kohëve të ndryshme, e vendeve të ndryshme me nga një kangë ndërlidhse. Kshtu, simbas rendit kronologjik vuni në vendin e parë Oso Kukën. Por në të vertetë ndërgjegja e të gjithë shqiptarëve për të mbrojtë tokat e të parëve filloi me Lidhjen e Prizrenit 1878. Kshtu Fishta poet në Lahutën e Malcis ka *gjashtë cikle luftash* të cilat me nga një kangë ndërlidhse autori të dërgon ndër kohë e vende të ndryshme. Në botimin përfundimtar të vjetës 1937 kemi kët skemë:

Cikli i Parë: Oso Kuka

Cikli i Oso Kukës pesë kangë, ose lufta e Vraninës në vjetin 1858. Kanga e gjashtë [ndërlidhësja]: Dervish Pasha paraqet një perjudhë njëzet-tridhetë vjeçare luftash turke-malazeze.

Cikli i Dytë: Lidhja e Prizrenit

Lidhja e Prizrenit (1878) përfshinë katër kangë. Kanga ndërlidhse është Lugati ose Kanga e 11të.

Cikli i tretë: Te Ura e Rrzhanicës

Te Ura e Rrzhanicës (1880) që përfshinë që prej Kangës 12-të deri në të 15-tën. Si kangë ndërlidhëse vjen Kanga e 16-të: Kulshedra.

Cikli i katërt: Te ura e Sutjeskës

Te ura e Sutjeskës që përfshinë që nga Kanga e 17 -të deri te Kanga e 21-të, nëpër të cilën bahet ndërlidhja me ciklin pasues.

Cikli i pestë: Tringa

Tringa që përfshinë që nga Kanga 22të deri te e 25-të. Kanga e 26-të: Koha e re, ndërlidhë perjudhën e luftave të kohës së Lidhjes së Prizrenit me ato në zhvillim në shekullin e njëzetët.

Cikli i gjashtë: Dedë Gjo Luli

Dedë Gjo Luli ose kryengritja e malsorëve në vjetin 1911 që përfundon me traktatin e Londrës më 1913.

Ripunimi i veprës

Fishta me gjetjen gjeniale të këtyne katër kangëve ndërlidhse filloi edhe një herë ripunimin e unifikimin e ktij poemi mjaft të ndërlikuem ndërsa ndër kto katër kangë, si pjesë përbase të poemit epik shqiptar, ai përshkruen jo vetëm një pjesë të historisë, por më tepër na jep në dorë mitologjinë e vertetë shqiptare me shtriga e lugetën, dragoj e "kulshedra, orë, zana e shtojzovalle, të bukurat e dheut e me gjithshka tjetër që fantazia e pakufishme e një populli malsor, të pa rysun nga dijet e shkollave, paraqet e spjeron të gjitha fenomenet të spjegueshme e të paspjegueshme natyrore e mbinatyrore ndër të cilat jeton.

Kur Fishta vendosi me e përpunue krejtësisht poemën e muer që nga fillimi. Si ndër të gjitha poemat klasike ai në fillim bani një protasis ose hymje poetike të përmbajtjes së luftave që tregohen

aty. Ky protasis përfshinë jo më pak se 270 rreshta të kangës së parë që titullohet Cubat, marrë nga cikli i Oso Kukës. Nga cikli i këtij eposi, botim i vjetës 1907, me atë të vjetës 1937, ndryshimet shifen kryesisht jo në tekstin, po: ndër tituj dhe ndamjen e tekstit.

Si kohë e zhvillimit historik, ajo që paraqitet në protasis, fillon që në vjetën 1834 kur ishte në Mal të Zi Vlladik Petar Njegosh i dytë deri në vjetën 1854. Ndërsa luftat fillojnë në vjetën 1856-1858.

Dervish Pasha ose kanga e gjashtë na paraqet perjudhën e luftave turko-malazeze që nga vjeta 1858-1876, ose lufta me të cilin u muer Kongresi i Berlinit.

Cikli i dytë: Kuvendi i Berlinit me katër kangë të cilat paraqesin Lidhjen e Prizrenit e vendimin e shqiptarëve për të mbrojtë tokat e veta.

Lugati: është kanga ndërlidhse para se të fillojnë frontet e betejave shqiptare.

Cikli i tretë i Marash Ucit me të cilin u botue së pari në 1905 Lahuta e Malcis me pesë kangë, ndërsa në botimin e 1937 u hoq kanga e katërt e këtij cikli e u vu kjo në gojën e Lulash Ndreut, si episod i kangës së nandëmdhetët, në faqen 416-495. *Kulshedra* është kanga ndërlidhse e gjashtëmdhetët. Ktu poeti portretizon dragojt shqiptarë ose një luftë hipotetike që simbolizon luftën e shqiptarëve me një pushtues.

Cikli i katërt edhe ky përmban katër kangë, ose më mirë thomi pesë, sepse me anë të një episodi të fundit të kangës *Ndermjetsia* poeti e çvendosë luftën në një tjetër front lufte për të na dërgue te cikli i pestë

Cikli i pestë: Tringa me katër kangë me të cilin mbaron edhe periudha e luftave të popullit shqiptar për të mbrojtë tokat e veta (1880).

Koha e re ose kanga e njëzetegjashtët që lidhë ngjarjet e shekullit të nandëmdhetë me ato të fillimit të shekullit të njëzetë ose luftat deri atëherë të zhvillueme nga shqiptarët për mbrojtjen e tokave të veta nga "shkjau" sllav, ndërsa tash shi ata malsorë e të bijtë e po atyne do të zhvillojnë luftat e tjera për të largue pushtuesin turk.

Mendoj se kjo kangë është ajo që italianët e thrasin "Canto del cigno" ose kanga e mjellmës, sepse ajo para se të mbarojë jetën e vet këndon melodinë më të bukurën, kështu edhe në kangën *Koha e re* poeti e ndien vedin të plakun e thotë:

A din shka moj gerxheli.
Mori rrezja nper frangi:
Se mue kripit m'i ra bora,
Se kah m'len është kama e dora,
Se edhe as vonë, tham, s'ka me shkue,
N'jetë pertej un pa kalue,
Prej kah s'lanë kend me u kthye dalë ...
Pra ndigjioma ktu një fjalë:
(rr. 35-42)

Poeti e shef se ka shkue tepër gjatë pa u përfundue poemi i filluem në rini, prandaj don të shkrijë edhe një herë gjithë vrullin poetik për me i dhanë veprës një përfundim të pritun nga të gjithë shqiptarët e i kërkon Zanës që ta ndihmojë, sepse gjatë shumë vjetësh poeti kishte përballue një jetë tepër të ngërthyeme ndër të gjitha çashtjet jetike të kombit, gjatë të cilave Zana nuk e frymzonte. Në këtë kangë e thrret aty në Lezhë, qytet antik i ilirëve me mure çiklopikë qandër e kujtimeve legjendare të të kaluemes ilire, arbnore e shqiptare, ku ndodhi vdekja e Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit. Në të vertetë Fishta kishte projektue restaurimin e Kuvendit të vjetër të Franëskanëve; aty kishte rezervue një dhomë për vete që të përfundonte Lahutën e Malcis. Kjo dhomë në të cilën Fishta punoi, mendoj se duhet të shpallet monument kulture e të mbrohet nga kombi.

Po kthej te poemi: Kemi:

Ciklin e gjashtë ose Dedë Gjo Lulin. Në këtë cikël përshkruhet lufta e fundit e shqiptarëve për pamëvarsi dhe përfshin edhe kjo katër kangë të cilat përfundojnë me njohjen e Shqipnisë në arenën ndërkombëtare, në Konferencën e Londrës 1913.

Poemi dhe realiteti historik

Fishta nuk kishte kurr ndërmend me shkruar një histori të Shqipnisë as të popullit të saj, por një poem i cili të paraqiste në mënyrën më të bukur disa shembuj urtije, trimnije e sakrificash me të cilat mjaft shqiptarë i kishin dhënë hov lëvizjes patrotike edhe në se jo në emën të saj. Po e marrim që nga fillimi.

Cikli i Parë

Oso Kuka. Kush ishte ky hero? Nuk ish tjetër, por vetëm një mercenar shkodran në shërbim të Turakisë. Ai nuk e kishte aspak ndjenjën e "*shqiptarizmit*" të shekullit XX, e ndoshta-ndoshta, sikur të ia përmendje atij Shqipninë, nuk e dijmë se çdo të kishte ndodhur. Këtë e dinte aq mirë Fishta sa në polemikën që pat me Z. Mehdi Frashërin, emnon shi këtë hero. Por aso kohe nuk kqyrej çashtja si sot. Oso Kuka kishte nderin e vet personal edhe pse ishte mercenar, kishte edhe nderin e qytetit, ose të krahinës së vet, të llojit, të fisit të vet shqiptar, pamëvarsisht në se ishte nga Shkodra, nga Elbasani, Berati, Vlona e Çamëria, Prishtina a Peja. Në të vertetë aso kohe ndjenja nacionale ndër kto vise ende nuk ishte zhvilluar, por ajo ndera individuale dhe e fisit ishin kryesoret. Kaq i mjafton Poetit që ta shpallë "Hero i Kombit". Mendoj se ia duel. Ia duel ndër shumë pikpamje. Shqipnia që do të bahej ishte tepër e përçame si ndër krahina ashtu edhe ndër fe ose besime.

Sikurse në lojën kombëtare mos të hinte besim mysliman atëherë Shqipnia nuk do të bahej kurr, sepse të krishtenët, ortodoksë e katolikë, ishin e janë në pakicë. Kjo është merita e madhe e Fishtës që synonte bashkimin e të gjithë shqiptarëve, pa dallime feje e as krahinash. Për këtë qëllim ai në çetën e Osos të gjithë luftarët i ka të përziem sa myslimanë aq edhe katolikë, deri Prenk Markolën e

Mirditës. Fakti është i vertetë që ata shqiptarë, pa përjashtim atë ditë u flijuen të gjithë, për nderin e vet personal dhe të fisit. Fisi është kombi.

Cikli i Dytë

Në ciklin e dytë është "Lidhja e Prizrenit". Sa lidhje ka "Lahuta e Malcis" me realitetin historik? Pothuej asgja. Në poemën Fishtjan paraqitet sikur Ali Pashë Gucia e Haxhi Zeka të ishin Nismëtarët e Lidhjes së Prizrenit. Ndërsa e verteta historike qëndron shumë larg. Nuk ishin as Ali Pashë Gucia as Haxhi Zeka as Abdyl Frashëri. Në të vertetë ishte Çami i madh Abedin Pashë Dino, asokohe Ministër i Punëve të Jashtme të Turqisë, i cili si shqiptar mendonte që mos t'u lëshohej asnjë pllamë e tokës së shqiptarëve kombeve të huaja sllave. Prandaj ai thirri mikun e vet më besnik, Abdyl Bej Frashërin, asokohe deputet i Mishlizit në Stambollë, dhe e ngarkon që të shkonte në ato vise të truellit të shqiptarëve që në bazë të traktatit të Berlinit, do t'u lëshoheshin sllavëve. Abedin Pasha, tue shfrytëzue politikën europjane të kohës që mbështetej mbi "vetvendosjen e popujve" ai, po mbi parimet europjane, i tha Abdyl Bej Frashërit nga Përmeti që të thirrte Lidhjen e Prizrenit që shqiptarët të kërkonin "të drejtat e vetvendosjes. Mjerisht në seancën e saj të parë ajo u emnue *"Lidhja e Myslimanëve të Vertetë"*. Kështu thonë proceverbalet në rasë se duem të shkruejmë historinë e vertetë. Atë kushttrim në emën të Islamizmit nuk e ndigjoi kurrkush në botë. Ndërsa në një seancë tjetër, në të cilën muer pjesë delegacioni i Shkodrës, Z. Filip Çeka (Suma), në shtëpinë e të cilit banonte konsulli anglez në Shkodër, parashtroi kërkesën që ajo të thirrej "Lidhja Shqiptare e Prizrenit". Si përfaqësues i kësaj Lidhje u paraqit në Berlin Abdyl Frashëri, i cili kërkoi me ngulm të drejtat e shqiptarëve. Bismarku iu përgjegj se "Shqipëria ishte një nocion gjeografik, ndërsa Kongresi i Berlinit ishte mbledhë për të rregullue sa të ishte e mundur, popujt që luftuen kundër Turqisë, e populli shqiptar nuk kishte zhvillue lufta kundër saj". Abdyli atëherë i përmendi kryengritjet e vazhdueshme të Mirditës edhe asokohe.

Kongresi i Berlinit ia dha në letër autonominë Mirditës, e cila për traditë konsiderohej nën mbrojtjen e Frengjistanit ose të Francës. Ndërkaq zbatimi i neneve të Traktatit të Berlinit iu la Austro-Hungarisë për zbatim e cila nuk u interesue kurr për autonominë e asaj krahine aq të vogël, mbasi mendonte që ajo vetë ta zevendësonte Portën e Naltë mbi viset e Ballkanit. Edhe ktu Çami i madh Abedin Dino u përpoq me anë të një politike të fshehtë familjare që të përçajë fuqitë europjane. Dihet se Dinollarët ishin katër vllazën: një banonte ndër çifliqet e pamatuna e prodhuese të Çamërisë; tjetri merrej me politikën e naltë të Perandorisë Osmane në Stambollë. Ndërkaq dy vllazent tjerë banonin njani në Paris e tjetri në Romë, nga ku vërenin me kujdes të gjitha ernet që fryjshin në politikën europjane. Kështu, përmes vllaut të vet në Romë i sugjeroi shtetit të ri italian dishirin për të zotnue të dyja brigjet e ngushticës së Otrantos, mbasi ai vetë i njëjti mirë edhe qëllimet politike austro-hungareze karshi asaj perandorije që kishte mbete tepër mbrapa Europës. Æsht për tu kja se si historiografia shqiptare nuk e xuni kurr në gojë kët familje.

Fishta e paraqet në poem Lidhjen e Prizrenit si të ishte një bashkim folklorik malsorësh shqiptarë për rasa të jashtëzakonshme, ku kryet e vendit e xen Ali Pashë Gucia e fjalimin kryesor e mban Abdyl Frashëri "me kollçikë e me fistan". Për këtë poeti kje kritikue nga Z. Mehdi Frashëri, por Fishta iu përgjegj flakë për flakë në Hyllin e Dritës tue spjegue se poemi kishte për qëllim jo me tregue të vertetën siç ish, por të vertetën ideale. Ai e dinte mirë se Ali Pashë Gucia ishte një boshnjak i martuem me një vashë shqiptare e që komandonte vetëm një front të caktuem, atë të Gucisë e Plavës ku do të luftonin shqiptarët për trojet e tyne kundra Malit të Zi, e prandej edhe Fishta e vendosë në krye të Lidhjes Shqiptare.

Poemi gjatë ktiy cikli nuk ka asnjë aksion luftarak, përveç vrasjes së Mehmet Ali Pashës në Gjakovë. Në pamje të parë duket sikur kemi të bajmë me një episod të zakonshëm të shqiptarëve që grinden midis vedit për çdo çashtje. Jo nuk është puna aty: është aksioni i parë

që merrej drejt për së drejti karshi Portës së Naltë ose kundra vendimeve të vetë Sulltanit-Kalif. Në të vertetë Mehmet Ali Pasha nuk ishte turk me origjinë, por një ekspert i naltë ushtarak austro-hungarez, që kishte shkue me modernizue ushtrinë turke në Stambollë. Gjatë kësaj kohe ishte islamizue dhe kish marrë emnin Mehmet Ali, ndërsa populli e thrriste "Mehmet Pashë Maxharri". Gjatë luftës të vjetit 1876 kje kolaudue zotsija e tij edhe në reformat ushtarake. Kje edhe një ndër pjestarët kryesor të delegacionit turk gjatë Kongresit të Berlinit, për mos me thanë kryesori, mbasi Porta e Naltë, nga ana e vet, e caktoi si përfaqësues ne zbatimin e neneve të Traktatit të Berlinit. Prandej zemrimi i shqiptarëve kundër sjelljeve të tija paraqitet si të ishte kundra babës-mbret.

Mendohej nga të vjetrit se tanë atë çorbë ia pregatiti Abedin Pashë Dino.

Në ciklin e tretë

Te Ura e Rrzhanicës pothuej heroi kryesor na çfaqet Marash Uci. Në fakt ky ishte një burrë malesh i njoftun për urti, por ndërkaq ishte edhe korrier i konsullatës austriake në Shkodër për malsorët e Malsisë së Madhe. Ky fakt vertetohet po aty në poem: shif këngën XII, rr. 146 deri 158:

Kam kenë n'Shkoder, mbram kam ardhë,

Ke qaj miku faqe-bardhë,

etj.

Ai miku faqe-bardhë ishte kryekonsulli austriak. Gjithashtu në këngën që vazhdon, atë të XIII, *Te Kisha e Shnjonit* diku andej nga mbarimi, pikërisht ndër rreshtat 255 e kryesisht: rr. 263 thotë:

E atij mikut, iu ngjatët jeta!

Thuej t'a qesë një shkrolë n' gazeta

..... deri në rr. 274.

Pra duhet t'i kuptojmë mirë se "Ai miku nuk ishte tjetërkush, por austro-hungaria.

Sa për luftën te Ura e Rrzhanicës ajo pothuej se nuk u ba fare.
Arsyet ishin kto:

Strategjia e Knjazit dhe ajo e Mark Milanit ishin të ndryshme. Duhet të dihet se Mark Milani është heroi kryesorë i Malit të Zi, vjen fill mbas Petar Njegoshit të dytë. Shtëpia e tij është muze kombëtar i Malit të Zi. Strategjia e Mark Milanit ishte që zonat me popullsi katolike duhej të merreshin me të mirë e me miqsi. Për këtë qëllim ai kishte shkruar edhe libra mbi zakonet e malsorve e për më tepër deri vajzën e vet më të vogël e kishte fejuar në Hot e kështu nuk kishte kurrfarë dishirit që ta prishte këtë miqsi të re. Ndërkaq Knjazi mendonte se rruga më e shkurtë me hi në Shkodër ishte ajo e Hotit dhe aty drejtoi ushtrinë, tue menduar se malsorët katolikë do ta pritshin krahapun. Por nuk ndodhi ashtu. I pari malazias që hini në urë mbetë dekur në vend. Mark Milani dha urdhën të pezullohej sulmi, deri në një urdhën të dytë, ndërsa grupi i rojeve shqiptare i dha kushtrimin Hotit e Grudës. Ndërkaq, tue pa se malazezët nuk po sulmonin, njëri nga rojet e pritës shqiptare hini në urë për me i marrë armatimin të vdekunit, por mbetë edhe ai vetë shi në atë urë. Kta dy vetëm kjenë viktimat e kësaj lufte për të cilën poeti tregon gjithë ato trimni nga të dyja palët. Këtë dishmi e kam ndigjuar kur ishem i ri prej pleqve të saktë. Mbas kushtrimit të rojeve shqiptare, kur zbritën Hoti e Gruda në breg të Cemit, Mark Milani i dha urdhën malazezve që të ktheheshin mbrapa.

Cikli i tretë e i katërt

Luftat në Qafë Hardhi dhe te Ura e Sutjeskës paraqet, mund të thomi, luftën e vendosun që shqiptarët bane aso kohe për mbrojtjen e tokave të veta. Sigurisht që poeti edhe në këtë luftë ka shtirë edhe shumë personazhe, të cilat nuk kanë marrë pjesë, por fakti është historik, se aty u zhvilluen luftime për mbrojtjen e Plavës e të

Gucisë, ku muer pjesë pothuaj pjesa më e madhe e malsive veriore të Shqipnisë.

Cikli i pestë

Tringa. Nuk di çka me thanë. Gjatë rinisë sime kamë pyetë e stërpyetë mbi këtë episod heroik aq të bukur, por kurr nuk kam marrë përgjegjen as po as jo. Ndoshta ndoshta krejt ky cikël është ndërtue nga poeti në ngjasim të legjendës madhshtore të motrës së Gjergj Elez Alisë, për me u tregue shqiptarëve se nderi personal është nderi i fisit e i kombit.

Cikli i gjashtë

Dedë Gjo Luli: pa kurrfarë dyshimi mund të thom se ky është cikli me vertetsinë më të madhe historike. Poemi nuk ka pak fantazi, por vetëm realizëm historik. Ndërkaq Fishta, poet, por edhe analist, i përshkruen ato ngjarje ndër të cilat, ndoshta, kishte duert në brumë edhe ai vetë personalisht, me një saktësi të egër, si mjeku që shtjen gishtin në plagë dhe mendon e çmendon se cilat ilaçe duhen përdorë për të shpëtue kombin nga vdekja e për t' i dhanë jetën, lirinë. Poeti nuk përcakton ditën e lirisë me 28 Nandor 1912. Jo. Ajo ditë ishte vetëm e idealistave shqiptarë, nën mbështetjen e Austrisë. Por nuk e njihte kurrkush në botë. Duhej që komuniteti ndërkombëtar të thonte fjalën e vet në Konferencën e Londonit më 1913. Pse Fishta nuk e vendosë datën 28 Nandor 1912 si ditën e pamëvarsisë, por ia len Konferencës së Londonit? Kjo pyetje ka edhe shumë përgjigje. Duhet dijtë mirfilli nga histori-shkruesit shqiptarë se gjatë shekujve, gjatë çdo kryengritje e revolte naltohej edhe flamuri, simbol i lirisë. Por kush i njofti ato? Kemi shembullin e fundit, atë të Deçiqit (Bratilës) në vjetin 1911, i cili ushtoi shumë në shtypin europian të kohës, por mjerisht nuk kishte asnjë mbështetje politike të Fuqive të Mdhë të kohës. Prandej, lufta e Malsive mbaroi me një traktat autonomie në mes shqiptarëve dhe Portës së Naltë.

Gjithashtu m'at vonë Flamuri i Pamëvarsisë u naltue disa ditë përpara 28 Nandorit në Krujë e në Tiranë, por pa kurrnjë mbështetje politike të jashtme. Ndërsa 28 Nandori i 1912-tës mbështetej fuqimisht nga AustroHungaria, aq sa Fishta, në kangën e tridhetë ndër rreshtat 214-226, ia ven në gojë ambasadorit francez:

Eh, Madhni, as na s'ham bar;
Na edhe 'i kem', po, met n'kandar,
E kem' sy edhe me pa ...

Pra, pa i ba shumë koment, 28 Nandori i 1912-tës, ishte parashtrur në arenën ndërkombëtare për aprovim. Fishta nuk ishte vetëm patriot e poet, por ishte edhe një diplomat që e din se vetëm rregullat ndërkombëtare kan vleftën juridike në histori.

Analiza e mendime

Lahuta e Malcis - "Shkëmb i Popullit Shqiptar"

Kështu e përcaktoi Fishtën një tjetër poet i madh shqiptar, Lasgush Poradeci. Sikur t'i analizojmë fjalët e Lasgushit, del sikur Fishta të jetë shkambi mbi të cilin ndërtohet letërsia shqiptare, pra themeli i palëkundshëm, por gjithashtu "shkëmb" shenjon edhe majen m'at të naltë të maleve shqiptare, ose të letërsisë shqiptare. Në këtë rasë po më kujtohet një episod i jetës sime. Banojshem në Kuvendin Françeskan të Arra e Madhe në Shkodër. Prof. Pashko Gjeçi ishte lirur prej burgut, por nuk kishte kurfarë mundsie jetese, sepse si "llaçaxhi" nuk fitonte m'at shumë se 70 lekë në ditë. Kolegu im i klasës, Llazar Siliqi, aso kohe eksponent i Lidhjes së Shkrimtarëve, i kishte premtur se sikur të përkthente Danten do ta ndërlidhte dikund, atje te shkrimtarët. Por Gjeçi me punën e krahit nuk siguronte as bukën e gojës. Më lyp i ndihmë mue. Vinte përditë te un mbasi kisha një makinë shkrimit dhe letra. Të dy bashkë gjindeshim në një gjendje të jashtzakonshme. Erdh puna që ai fliste dhe un shkruajsh.

- Profesor, je tue përkthye "La Divina Comedia"?

- Po Fra Zef, por kurrkush në botë nuk e kupton si un e ti që kaluem Bedenin e Maliqin! ... Zef jepi makinës së shkrimit se vetëm ktu shpresoj me xjerrë bukën e gojës! ... Kjo kje letërsia e jonë. Ndërkaq flitshim edhe për letërsinë shqiptare. E ç'ish letërsia shqiptare me atë botnoren? As një hundë burmot! ...

- Profesor, po Fishta?

- Fishta? .. Fishta është ai që ka marrë në qafë të gjithë letërsinë shqiptare, sepse nuk i ka lanë kurrkujë vendin që meriton. Fishta është absolut në epikë, në lirikë, në dramë, në satirë edhe në publicistikë. Ndër të gjitha kto gjini letrare ai mbërriti kulmet. E çka të bajnë të tjerët mbas tij? ... Na ka mbetë në tjerëve vetëm proza e romanxeve, vetëm një fushë ku mund të konkurojmë, sepse ndër të gjitha tjerat ai ka mbërrijtë kulmet.

Në të vertetë, tue u kthye te Lahuta e Malcis, mund të thomi se është vepra madhore e letërsisë shqiptare. Na sot mund të dallojmë në te epikën, lirikën, satirën e gjykimin njerzor, me të gjithë fantazinë e pakufishme të popullit edhe të poetit. Për deri sot mbetet libri shejt i popullit shqiptar. Kje çasti historik që kët barrë ia ngarkoi Fishtës. Ai vetë e pranoi, pishmanë në se do t'ia delte në krye. Shkrini tanë jetën mbi te me të vetmin qëllim që të bashkonte kët popull të përçamë e të shprishun dhe t'i jepte një gjuhë të pasun e të bukur.

Sikur ta kqyrim me synin e ftoftë të kritikut, duhet të thomi se në krahasim me poema të tjerë të letërsisë botnore, xen një vend të veçantë, atë të popullit shqiptar, një diplomat që e din se vetëm rregullat ndërkombëtare kan vleftën juridike në histori, i cili është protagonist i vërtetë i këtij poemi, ndërsa rolin e antagonistit e kan popujt e tjerë që duen ta shtypin e robnojnë ose ti marrin tokat. Toka është jeta. Si përfundim Lahuta e Malcis është një poem epik që mbron jetën e lirinë e një populli.

Pse u luftue, pse u hodh aq baltë mbi të, gjatë një gjysë shekulli?

Shekulli XX kje shekull uraganesh. Historia e popujve është e çuditshme. Atëherë kur vezullon drita, mbas një çasti vjen terri. Lufta ndërmjet territ e dritës është e përhershme. Ndrron vetëm trajtat. Trajatat mund të paraqiten filozofike, shoqnore, fetare, krahinore. Në të vertetë është po ajo luftë e gjithmonshme e njerzimit mes dritës e territ, mes dashunisë e dhunës, mes dijes e padijes, mes së mirës dhe të keqes. Kush do të fitojë? Lufta është e përhershme. Periudha historike në të cilën u gjet fizikisht poeti kje ajo e Rilindjes ose e jetës dhe dritës. Aso kohe drita u thirr demokrati. Nuk vonoi e duel diktatura: dikund internacionale e tjetra nacionale, por në të vertetë të dyja njisoj ishin: diktaturë, dhunë. Erdh koha e dhunës e quejtun një herë fashiste, më vonë komuniste. Dhunë ishte. Liria u tkurr, po ashtu edhe poeti, natyrisht edhe poemi, gjithashtu gjuha shqipe. Kishin përballë një sfinks që thirrej "Enver". Në dukje paraqitej si Zeus i besimeve antike politeiste, por në të vertetë ishte monoteist i flaktë, që nuk pranonte jo vetëm besimin, por as mendim e tjeterkujt. Mjerisht shumë shqiptarë ende sot besojnë te Enveri, ose te terri, te dhuna. Enveri tha: të luftohet Fishta! Tue luftue Fishtën luftohej kombi. Tue luftue Fishtën luftohej gjuha shqipe, tipari kryesor i kombit. Tue luftue Fishtën luftohej bashkimi i shqiptarëve dhe bante që të përçaheshin më tepër si ndër fe ashtu në krahina. Ky kje qëllimi kryesor i asaj lufte të ashpër kundra Fishtës. Natyrisht që çdo kohë ka mercenarët e vet, militantat, rrugaçat, të gatshëm me shitë nanë e babë.

A ka të meta Lahuta e Malcis?

Si çdo vepër njerzore edhe ka. Æsht një vepër voluminoze me 15.600 e sa vargje krijue gjatë një perjudhe tridhetedy vjeçare.

Sigurisht aty shef kjartë kohën e rinisë si edhe të pleqnisë së poetit e ndoshta edhe problemet shumë të vështira që i suell koha e turbullt në të cilën jetoi e gjatë së cilës nuk mund kishte gjithmonë të njajtin frymzim poetik. Kështu ndeshemi shpesh në një proliksitet ose aq më shpesh në përsëritjen e disa rimave jo fort të bukura, apor edhe në përsëritjen e përshkrimeve të tipave njerzore si p.sh. çdo pashë me vetulla të trasha e të tjera mangësi të vogla, por të cilat kurrësi nuk i ulin vlerën këtij poemi madhor me bukuri të rrallë.

Kur u botue në vjetin 1937 varianti përfundimtar ishem fëmij në Kolegjin Françeskan. Gjatë një dreke vllaznore, Fishta pyeti: Si u duket? - dhe kërkoi që t'i banim kritika vllaznore. Të gjithë i thamë: Të lumtë Pater Gjergj! Por At Benardin Palaj iu drejtue: "Më duket se në këtë episodin e fundit ke këndue çka ish për t'u kja dhe ke kja çka ish për t'u këndue". Pater Gjergji si u mendue pak iu përgjegj: "E di Benardin, e di çka don me thanë. E ke fjalën për luftën e Ded Gjo Lulit në Bratille të Deçiqit që i kam dhanë një rol kryesor Hilë Mosit, ndërsa Luigj Gurakuqin vetëm sa e kam përmendë me malsorë tjerë. Ti e din se para opinionit shqiptar më mbetet mue sikur e mbyta Hilë Mosin me atë polemikën "Gabove Hilë!...", sepse ai diq pak kohë mbas asaj polemike. Mue më ka mbetë si mulla në zemër, megjithse nuk i kam pikë faji, prandëj i vuna në Lahutë atë që kishem caktue për Luigj Gurakuqin, tue e dijtë se çdo histori Shqipnije nuk mund shkruhet pa i dhanë këtij at rol kryesor politik e kulturor që pat në formimin e Shqipnisë.

Krahasime me tjera letërsi botnore

Nuk don aspak mend që të thomi se poemat epike të letërsisë botnore kan shumë gjasime mes vedit ose njana-tjetrës. Janë virtutet e trimnis e të burrnis njerzore, bujaris e sakrificave deri në heroizëm, janë këto virtute që i bajnë poemat epike të gjashme me njana-tjetrën, e jo se poetët e mdhaj kan shfrytëzue ose kopjue njani-tjetrin, siç guxojmë me thanë sot na kritikët e vogjël. Kur kemi studjue letërsitë botnore kemi ndigjue edhe për Firdusin persjan e

sidomos për episodin e dhimbshëm që, ndërsa trupi i tij po barej në tabut ndër vorre, shi atëherë te dyert e qytetit po hinte karvani me monedha të arta që Shahu i Persisë ia dërgonte si shpërblim.

Ditën e funeralit të Fishtës mbajti një fjalim edhe Hafiz Ali Tari, një ndër burrat më të përmendun të asaj kohe në Shkodër e Shqipëri. Ai e krahasoi Lahutën e Malcis vetëm me poemën "Shahname" ose poemën persjane shkruar nga Firdusi, poemë e cila përfshinte shumë lufta e shumë heroj gjatë një periudhe historike.

Ndoshta kështu mund e krahasojmë Lahutën. Fishta kishte një kulturë të gjatë letrare dhe kishte tentuar me përkthye në shqip këngë prej Iliadës së Homerit. Ai kishte zakon me na pyetë ne të rijve se cilin poet pëlqejshim më shumë. Ishem aso kohe 15-16 vjeç dhe një ditë mora zemër dhe e pyeta:

- Pater Gjergj, mirë se ti na pyet ne, por edhe unë kishem me dishrue ti diçka se cilin poet të pëlqen ty më shumë?

- Ah! fra Zef, më tha. A e din se kjo nuk është pyetje me ia bën kurrkuj? Unë të pyeta ty sepse dojshem me njëftë çfarë prirjesh ke, por duhet të diçka se të gjithë të mdhajt janë të mdhajt. Kur thomi Homerin, na duket se kurrkush nuk mbërrin te ai; po ashtu Horaci. Po Dante? Kurrkush më i bukur, po ashtu Petrarka. Nuk mund thomi se ky vjen i pari, tjetri i dyti, o i treti. Nuk janë vegzha, por poetët e botës që na kanë dhënë se çili në atë gjuhë e tyne ambjentin e vet, pikpamjet kryesore të njerzimit. Ndër këta njeriu pëlqen më shumë atë me të cilin e lidhin zakonet, doket, shprehjet e bota që e rrethon. Ty të duket fjalë e marrë e prandaj nuk mund e thom, por në të vertetë unë më për zemër kam Petar Njegoshin. Ndoshta ky pëlqim më vjen se na shqiptarët, malazezët edhe njata boshnjakët flasin dy gjuhë të ndryshme, por kemi të njëjtat shprehje që kanë ardhë si nga vendi ku banojmë, ashtu nga doket që kemi.

Kështu Fishta, megjithatë njëftë pothuaj të gjithë letërsinë e madhe europjane, parapëlqente letërsinë ballkanike.

Mendohet se Petar Njegoshin e ka imitue. Sikur mos të thellohem, edhe ashtu mund të paraqitet. Për shembull te kryevepra Kunora e Maleve kemi vajtimin e motrës së Bratiqit, ndërsa te Lahuta e Malcis kemi vajtimin e motrës së Avdi Hisës. Në asnjërin poem nuk kan emën, sepse në zakonet e asokohëshme nuk i përmendej emni aq kollaj, por paraqiten dy vajtime të përmortshme, ku gratë, nana ose motra në kjosin, vajtojn ashtu çka kan në zemër. Prandej edhe gjasojn mjaft mes vedit, por nuk don me thanë se njani poet e muer prej tjetrit. Për mâ tepër mund thom se kan një ndryshim thelbësor psikologjik. Ndërsa motra e Bratiqit në fund të vajtimit mbyhtë vedin, motra e Avdi Hisës lshon kushttrim për të marrë gjakun.

Si përfundim mendoj se koinçidencave, jo vetëm ndër disa fakte, por edhe ndër shum shprehje, nuk u duhet dhanë kuptimi i imitimit o i kopjimit, por janë shprehje të natyrshme njerzore që dalin nga shpirti i poetit të çdo kombi o gjuhe kjoftë ai, e i çdo kohe.

Lahuta e Malcis dhe folklori

Para njëqind vjetësh, më 1905, kur u botuen së pari të parat kangë të Lahuta e Malcis poeti pat të shkrueme në kopertinë "Kangë populllore". Me fjalë tjera Fishta i çmonte ato e ndoshta donte me i naltsue në art, mbasi së shumti ato paraqiteshin me të meta, sepse ishin qitë nga njerz analfabet. Sigurisht që nuk kishte ndër mend me ba një "Kalevala" shqiptare, por një poem i cili t'i përgjigjej shijes së hollë të popullit e që të hinte shum kollaj në veshin e tij. Për këtë punë ai zgjodhi tetërrokshin. Në mbrojtje të ktiij tetërrokshit Fishta zhvilloi një polemikë me Zalvin (Zef Valentinin) që aso kohe ishte kryeredaktor i revistës LEKA. Zalvi insistonte se dheterrokshi ishte metrika e vertetë kombëtare e shqiptarëve, sepse kangët e rapsodve lahutarë që këndonin Gjergj Elez Alinë etj. përdornin atë e jo vargun që përdorte Fishta në Lahutën e Malcis. Fishta iu përgjegj në Hyllin e Dritës tue i pru aq shumë argumenta në mbrojtje të tetërrokshit, si vargu i popullit. Mâ vonë Zalvi e pranoi.

Në të vertetë gjinden disa kangë popullore të cilat megjithse të qituna nga njerz analfabetë, janë aq të ngrituna artistikisht sa nuk ke as çka u hjek as çka u shton e të cilave çdo poet i regjun vështirë se do t'u a delte. Disa prej ktyne kangëve Fishta i merr edhe i shtjen në Lahutën e Malcís o tue i lanë ashtu siç janë, ose tue u ba ndonji qortim të vogël.

Marrim si shembull ciklin e Oso Kukës, të cilit i këndonte mjaft bukur një kangë shkodrane. Përpunimi i ksaj kënge popullore ktu në poem âsht sigurisht shumë më artistik e me një muzikalitet të veçantë në letërsinë shqipe, e pra megjithkëta ai përfundon me vargjet e kangës shkodrane:

Ah! kadalë o Nikollë Popi
Se ktu i thonë Oso Baroti!
Se s'ke pa shkodranë me sy,
Që djeg vedin edhe ty!...

ndërsa Fishta i ban vetëm këtë ndryshim:

Ah kadalë Nikollë, t'vraftë Zoti!
Se ktu i thonë Oso Baroti!
Se s'ke pa shqypat me sy,
Që djeg vedin e dhe ty!...

Pra, gjithë esenca e kangës shkodrane përmbledhej ktu e Fishta mendon që kjo të ruhet në poem po ashtu si i këndonte dikur populli.

Gjithashtu kemi edhe pak kangë të tjera, që aso kohe nuk i kishte mbledhë kurrkush, prandaj edhe do të hupshin me kohë, siç janë kangët e Mican Lekës e Bec Patanit dhe e Çul Patanit.

Në Kangën e njizetët Lekët që nga vargu 643 e deri te ai 695 âsht pothuaj fjalë për fjalë kanga popullore që këndohej nga malsorët e Lezhës. Po ashtu në Kangën e tetmdhetët qet një pjesë të kangës popullore të Mican Lekës, pothuaj pa ndryshim, që prej vargut 194 deri te ai 215. Mendoj se kritika nuk ka vend ktu. Âsht fakt i

njoftun ndër të gjitha letërsitë botnore që poetët e mdhaj marrin prej popullit për t'ia kthye gjithnji popullit edhe mâ të bukur.

Perfundim

E shkrova kët parathanje pors i t'ishem një student që jep tezin e letërsisë në provimin e maturës, për me tregue se e ka kuptue në thelb poemën epik shqiptar: Lahutën e Malcis. A jam i knaqun me kaq sa shkrova? Sigurisht që jo. Gjykimin do ta japin profesorat e mdhaj. Nuk jam i kënaqun për aq sa shkrova sepse për Lahutën mund të shkruhet edhe njëqind herë kaq. E kado që të kritikohet, e ka edhe ku kritikohet, ai prap se prap mbetet Poemi kryesor i letërsisë shqipe. Në të, gjuha shqipe ndien jonet e bilbilit, tufanet e maleve dhe ushtimën e termetit. Fantazia e poetit, po fantazi e popullit shqiptar, të dërgon mbi krahët e Zanave, atje nalt te luginat e bjeshkve me u fladitë ndër gurrat e krijta, currilat e të cilave ndrijnë si ylbera nën rrezet e diellit që po naltohet atje mbi shkrepat e thepisun ku ka truëllin bora e përhershme e dhinë e egra me bryna të artë. Atje mund takohesh me Orë e Shtozovallë, por edhe me dragoj e kulshedra, shtriga e lugetën e gjithshka të vjetër që pat mitologjia e një populli të paditun.

Okei!

Shkodër, 25.XI.2005